



Bazuar në nenin 35, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, të Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 77/16 Gusht 2010), si dhe nenin 85 të Ligjit nr. 04/L-093 për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 11/11 maj 2012), Bordi i Bankës Qendrore, në mbledhjen e mbajtur më datë 29 nëntor 2018, miratoi këtë:

Rregullore për procesin e vlerësimit të brendshëm të mjaftueshmërisë së kapitalit

Neni 1

Qëllimi dhe fushëveprimi

1. Qëllimi i kësaj rregulloreje është të përcaktoj procesin e vlerësimit të brendshëm të mjaftueshmërisë së kapitalit të bankës për të siguruar shumën, llojin dhe shpërndarjen adekuate të kapitalit që vlerësohet i nevojshëm për mbulimin e rreziqeve të bankës me qëllim të menaxhimit të rrezikut, përcaktimit të strategjive të rrezikut dhe planifikimit të kapitalit.
2. Kjo rregullore zbatohet për të gjitha bankat e licencuara nga BQK-ja për të operuar në Republikën e Kosovës.
3. Përveç nenit 31 paragrafi 3, dispozitat tjera të kësaj rregullore nuk zbatohen për degët e bankave të huaja.

Neni 2

Përkufizimet

1. Termat e përdorura në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me termet e përkufizuara sipas Ligjit Nr. 04/L-093 për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare jo-bankare (në vijim: *Ligji për bankat*), apo siç janë përkufizuar më poshtë për qëllimin e kësaj rregulloreje:
 - 1.1. **“Profili i rrezikut”** – është vlerësimi i ekspozimit të përgjithshëm të rreziqeve ndaj të cilave një bankë është ose mund të ekspozohet në operationet e saj në një moment të caktuar, duke përfshirë ndërlihdjet dhe rrezikun e koncentrimit. Ky vlerësim mund të marrë parasysh ekspozimin ndaj rreziqeve para ose pas zbatimit të masave të menaxhimit të rreziqeve;
 - 1.2. **“Gatishmëria e bankës për të marrë rrezik” ose toleranca e rrezikut** - është niveli i përgjithshëm i rrezikut i pranuar paraprakisht, përfshirë nivelet dhe llojet

e veçanta të rreziqeve, që banka është e gatshme t'i ndërmarrë me qëllim të realizimit të objektivave, strategjive, politikave dhe planeve të biznesit, duke pasur parasysh kapacitetin rrezik-mbajtës të bankës, strategjitë dhe politikat e saj për marrjen dhe menaxhimin e rreziqeve, si dhe kapitalin, likuiditetin dhe sistemin ose politikat e kompensimit;

- 1.3. **"Kufijtë e rrezikut"** - janë kufizimet e përshtatura sasiore dhe matjet me të cilat një bankë menaxhon marrjen e rreziqeve dhe koncentrimin e tyre ndërmjet produkteve, investimeve, linjave të biznesit, subjekteve në grup ose kritereve të tjera të menaxhimit të rrezikut. Këta lejojnë bankën të shpërndajë rreziqet përgjatë linjave të biznesit dhe llojeve të rrezikut, si dhe mundësojnë që banka të vendos në lidhje me gatishmërinë për të marrë rrezik, skenarë të ndryshëm stresi dhe kritere të tjera;
- 1.4. **"Kapaciteti rrezik mbajtës"** – përfaqëson nivelin maksimal të rreziqeve që një bankë është në gjendje të marrë duke u bazuar në bazën e kapitalit të saj, likuiditetin, menaxhimin e rreziqeve dhe masave kontrolluese, rezultatet e stres testit, si dhe duke marrë parasysh edhe kufizimet e tjera duke përfshirë ato rregullative;
- 1.5. **"Kultura e menaxhimit të rrezikut"** - është niveli i standardeve dhe vlerave që zbatohen nga banka, duke marrë parasysh vetëdijesimin e bordit të drejtorëve, menaxherëve të lartë dhe punonjësve të tjerë për rreziqet, që nëpërmjet veprimeve dhe qëndrimeve të tyre ndaj rrezikut të bankës dhe propozimet për funksionet e kontrollit të brendshëm, janë reflektuar në vendimmarrjen e tyre në lidhje me marrjen dhe menaxhimin e rreziqeve në nivel të aktiviteteve të përditshme të bankës dhe që ka ndikim në zbatimin e gatishmërisë për të marrë rrezik të pranuar nga ana e bankës.
- 1.6. **"Rreziku i koncentrimit"** është rreziku i ekspozimit të tepërt, qoftë të drejtpërdrejtë dhe/ ose të tërthortë që rrjedh nga rreziku i kreditorit të një banke ose grupi bankar kundrejt një klienti individual, një grupi klientësh të ndërlidhur ose klientëve të ndërlidhur si rezultat i faktorëve të përbashkët të rrezikut;
- 1.7. **"Rreziku i reputacionit"** është rreziku i humbjeve si pasojë e krijimit të një imazhi negativ ndaj bankës nga klientët, partnerët e biznesit, punonjësit, pronarët dhe investitorët, autoritetet mbikëqyrëse ose autoritetet tjera kompetente, ose edhe audienca të tjera relevante publike;
- 1.8. **"Rreziku strategjik"** është rreziku i humbjes si rezultat i vendimeve të gabuara të biznesit nga bordi i drejtorëve dhe menaxhmenti i lartë, moszbatimi i vendimeve të marra dhe reagimi i dobët i bordit të drejtorëve dhe menaxhmentit të lartë ndaj ndryshimeve në mjedisin e biznesor;
- 1.9. **"Rreziku i kapitalit"** është rreziku i humbjes si rezultat i përbërjes joadekuate të kapitalit në lidhje me natyrën dhe qëllimin e operacioneve të bankës, vështirësi me të cilat përballet banka në shtimin e kapitalit të nevojshëm dhe veçanërisht në

rast të nevojës për një rritje të shpejtë të kapitalit, si dhe në rast të kushteve negative të biznesit;

- 1.10. "**Rreziku i fitimeve**" është rreziku i humbjes si rezultat i përbërjes joadekuade ose diversifikimit të të hyrave ose paaftësisë së një banke për të siguruar nivele të mjaftueshme dhe të qëndrueshme të fitimeve;
- 1.11. "**Kërkesa e brendshme për kapital**" - është shuma e kapitalit të brendshëm, që banka e vlerëson të nevojshëm për të mbuluar rreziqet aktuale dhe të pritshme.
- 1.12. "**Vlerësimi i brendshëm i kapitalit**" - është kapitali i përlogaritur në bazë të përkufizimeve të brendshme të përbërësve të kapitalit nga banka;
- 1.13. "**Stres testi**" - nënkupton përdorimin e teknikave të ndryshme sasiore dhe cilësore për të testuar qëndrueshmërinë e bankës ndaj zhvillimeve të rënda negative, por, të mundshme, të përcaktuara nga banka në bazë të kombinimeve të ndryshmeve të faktorëve të rrezikut (skenarët e stres-testit);
- 1.14. "**Analiza e ndjeshmërisë**" është një teknikë më pak e komplikuar e stres testit, që përfshin një vlerësim të ndikimit të ndryshimit të një faktori të vetëm të zgjedhur të rrezikut në pozicionin financiar të një banke, ku shkak i goditjes nuk është përkufizuar;
- 1.15. "**PVBMK**" – do të thotë Procesi i Vlerësimit të Brendshëm i Mjaftueshmërisë së Kapitalit

Neni 3

Vlerësimi dhe sigurimi i brendshëm i mjaftueshmërisë së kapitalit

1. Banka duhet të ketë strategji dhe procese të përshtatshme, efektive dhe gjithëpërfshirëse për të vlerësuar dhe siguruar në vazhdimësi shumat, llojin dhe shpërndarjen e kapitalit të brendshëm, që vlerësohet i domosdoshëm për mbulimin e rreziqeve duke marrë parasysh karakteristikat dhe shtrirjen e rreziqeve ndaj të cilave banka është ekspozuar ose mund të ekspozohet gjatë operacioneve të saj.
2. Banka në bazë të rishikimeve të rregullta siguron që strategjia dhe proceset e përmendura në paragrafin e mëparshëm janë gjithëpërfshirëse dhe proporcionale në raport me natyrën, shkallën dhe kompleksitetin e veprimtarisë që kryen dhe mjaftueshmërinë e kapitalit të brendshëm për të mbuluar ato rreziqe.

Neni 4

Lidhja ndërmjet strategjisë së biznesit të bankës dhe strategjisë së rrezikut

1. Me qëllim të implementimit efektiv të procesit të vlerësimit të brendshëm të mjaftueshmërisë së kapitalit, bordi i drejtorëve dhe menaxhmenti i lartë duhet të sigurojnë që objektivat e biznesit, strategjitë dhe politikat e bankës të jenë të lidhura në mënyrë të përshtatshme me strategjitë dhe politikat e rrezikut të përmendura në nenet 5 dhe 6 të kësaj rregulloreje.

2. Kur objektivat, strategjitë dhe politikat e biznesit të bankës të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni ndjekin qasje të gatishmërisë së marrjes së lartë të rrezikut, bordi i drejtorëve, duke marrë parasysh natyrën, shkallën dhe kompleksitetin e rreziqeve të vetvetishme në modelin e biznesit të bankës dhe aktivitetet e ndjekura nga banka, siguron qeverisje të brendshme korporative dhe efektive në përputhje me shkallën e pranimin të rreziqeve.
3. Strategjia e rrezikut që nuk bazohet në qeverisje efektive të brendshme korporative mund të pasqyrohet në rrezikun strategjik të bankës dhe në marrjen e tepërt të rreziqeve.

Neni 5

Strategjitë e rrezikut

Banka duhet të vendos dhe të zbatoj strategji efektive dhe gjithëpërfshirëse për marrjen dhe menaxhimin e rreziqeve të përcaktuara në nenin 9 paragrafët 1 dhe 2 të kësaj rregulloreje (në tekstin e mëtejshëm: strategjitë e rrezikut), që marrin parasysh strategjinë e biznesit të bankës dhe interesat afatgjata të saj, duke përfshirë mbrojtjen e interesave të kreditorëve të pasiguruar të bankës. Strategjitë e rrezikut duhet të jenë bazë në përcaktimin e objektivave të bankës dhe në qasjen e përgjithshme për marrjen dhe menaxhimin e rreziqeve, duke përfshirë përkufizimin e gatishmërisë së bankës për të ndërmarrë rrezik, duke marrë parasysh edhe faktorët në mjedisin e brendshëm dhe të jashtëm të bankës si dhe veçoritë e rreziqeve.

Neni 6

Politikat e rrezikut

1. Banka duhet të vendos dhe të zbatoj politikat për marrjen dhe menaxhimin e rreziqeve të përcaktuara në nenin 9 paragrafët 1 dhe 2 të kësaj rregullore (në tekstin e mëtejshëm: politikat e rrezikut) me qëllim të implementimit të strategjive të rrezikut të përmendura në nenin 5 të kësaj rregullore.
2. Politikat e rrezikut të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni duhet të sigurojnë përkufizime të hollësishme të funksioneve, sistemeve, proceseve, procedurave, metodologjive dhe të qeverisjes së brendshme korporative, përfshirë kompetencat dhe përgjegjësitë përkatëse, si dhe rrjedhën e raportimit ndërmjet të gjitha niveleve hierarkike dhe strukturës organizative të bankës.

Neni 7

Gatishmëria për të marrë rrezik

1. Banka duhet të sigurojë që marrja e rreziqeve në çdo moment të jetë në përputhje me gatishmërinë për të marrë rrezik të referuar në nenin 2 paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 të kësaj rregullore. Qasja e bankës për realizimin e gatishmërisë për të marrë rrezik është integrale, duhet të marrë parasysh interesat e pronarëve të bankës dhe palëve të tjera të interesit, duhet të bazohet në politika, procese dhe kontrolle të brendshme të bankës, si

dhe duhet të marrë parasysh përgjegjësitë përkatëse të funksionit të menaxhimit të rrezikut dhe funksionit të pajtueshmërisë.

2. Bordi i drejtorëve aprovon dhe shpjegon qasjen e bankës për realizimin e gatishmërisë për të ndërmarrë rreziqet e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni, në bazë të deklaratës së gatishmërisë për rrezik, ashtu siç është përcaktuar në nenin 9 paragrafi 9 të Rregullores mbi Qeverisjen Korporative të Bankave.

Neni 8

Kapaciteti rrezik mbajtës

1. Banka duhet të sigurojë që marrja e rreziqeve të rëndësishme në çdo moment të jetë brenda kuadrit të kapacitetit rrezik mbajtës (kapaciteti absorbues i rrezikut) të përmendur në nenin 2 paragrafi 1, nënparagrafi 1.4 të kësaj rregullore.
2. Banka ndërton metodologji për vlerësimin e kapacitetit rrezik mbajtës në çdo kohe, e cila merr parasysh:
 - 2.1. Të gjitha rreziqet domethënëse që banka ndërmerr brenda kornizës së operacioneve të saj, duke përfshirë ndërveprimet dhe koncentrimin e rrezikut;
 - 2.2. Masat në dispozicion për menaxhimin e rreziqeve të identifikuara dhe të vlerësuara;
 - 2.3. Kapitalin dhe likuiditetin e bankës;
 - 2.4. Kufizime të tjera, duke përfshirë çdo kufizim që rrjedh nga aktet nënligjore të bankës, rregulloret dhe standardet ose kërkesat e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.
3. Kur rreziqet specifike ose faktorë të tjerë nuk merren parasysh gjatë vlerësimit të kapacitetit rrezik mbajtës, banka shpjegon se cilat janë këto rreziqe dhe faktorë, duke dhënë arsyt pse nuk janë marrë parasysh.
4. Banka duhet të vlerësoj rregullisht kapacitetin rrezik mbajtës, duke përfshirë edhe çdo ndryshim të rëndësishëm në ekspozimin ndaj rreziqeve të ndërmarra. Vlerësimi i kapacitetit rrezik mbajtës duhet të dokumentohet. Banka duhet të shqyrtojë përshtatshmërinë e metodologjisë për vlerësimin e kapacitetit rrezik mbajtës të paktën një herë në vit, duke përfshirë propozimet për përditësimet e mundshme.

Neni 9

Rreziqet e bankës

1. Rreziqet që banka ndërmerr brenda kuadrit të veprimtarisë së saj mund të përfshijnë rrezikun kreditor dhe rrezikun e kundërpalës, rrezikun e koncentrimit përbrenda strukturës së rrezikut kreditor, rrezikun e tregut, rrezikun e normës së interesit, rrezikun e likuiditetit, rrezikun operacional (përfshirë rrezikun ligjor), rrezikun e valutës, rrezikun e pajtueshmërisë, rrezikun e modelit, rrezikun e reputacionit, rrezikun strategjik, rrezikun e kapitalit, rrezikun e fitimeve, rrezikun e levës së tepërt dhe rrezikun e sekjuritizimit.

2. Banka duhet të sigurohet që në çdo moment të jetë në gjendje të menaxhojë të gjitha rreziqet e tjera të rëndësishme si në bazë të konsoliduar, ashtu edhe atë individuale. Rreziqet e rëndësishme duhet të identifikohen në fillim, të trajtohen në mënyrë gjithëpërfshirëse, të monitorohen brenda kuadrit të aktiviteteve të përditshme të bankës dhe të paraqiten në kohën e duhur tek bordi i drejtorëve, menaxhmenti i lartë, departamenti i auditimit të brendshëm dhe departamenti i pajtueshmërisë. Menaxhimi efektiv i rrezikut zvogëlon mundësinë e humbjeve të papritura dhe rrjedhimisht pengon rrezikun e reputacionit që rrjedh nga humbjet e tilla.
3. Përveç kërkesave të përgjithshme në lidhje me menaxhimin e rrezikut të përcaktuar në këtë rregullore, banka plotëson edhe kërkesat për trajtimin e rreziqeve në vijim:
 - 3.1. Rreziku i kredisë;
 - 3.2. Rreziku i likuiditetit;
 - 3.3. Rreziku operacional;
 - 3.4. Rrezikun e tregut.

Neni 10

Procesi efektiv i menaxhimit të rrezikut

1. Banka siguron procese efektive të menaxhimit të rrezikut për identifikimin, matjen ose vlerësimin, menaxhimin dhe monitorimin e rreziqeve, duke përfshirë planet e rimëkëmbjes dhe raportimin e rreziqeve ndaj të cilave banka është ose mund të ekspozohet gjatë veprimtarisë së saj.
2. Proceset e menaxhimit të rrezikut të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni konsiderohen efektive nëse lehtësojnë prodhimin/krijimin e cilësisë së lartë të vlerësimeve, analizave, raporteve, propozimeve të masave dhe rezultateve të tjera të këtyre proceseve, duke përfshirë vlerësimin e brendshëm të kërkesave të kapitalit të bazuar në rrezik dhe vlerësimin e kapitalit të brendshëm, në bazë të të cilit bordi i drejtorëve dhe menaxhmenti i lartë janë në gjendje të marrin vendime afariste që janë në përputhje me gatishmërinë e bankës për të ndërmarrë rreziqe dhe masa të tjera në lidhje me realizimin e qeverisjes së qëndrueshme korporative në bankë.
3. Banka duhet të sigurojë planifikimin sistematik të zhvillimit të proceseve të menaxhimit të rrezikut të përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, me qëllim të përshtatjes efektive të tyre ndaj çdo ndryshimi në profilin e rrezikut të bankës, rreziqet e mjedisit të jashtëm dhe në praktikat më të mira në menaxhimin e rrezikut.

Neni 11

Identifikimi dhe vlerësimi ose matja e rreziqeve

1. Procesi i identifikimit të rreziqeve duhet të sigurojë që janë marrë parasysh të gjitha rreziqet e rëndësishme të përmendura në nenin 9 paragrafët 1 dhe 2 të kësaj rregulloreje. Identifikimi i rreziqeve të rëndësishme përfshinë:
 - 1.1 Analizën gjithëpërfshirëse të rrezikut, duke përfshirë rreziqet që mund të kenë ndikim negativ në fitimet e bankës, likuiditetin dhe vlerën e bankës;

- 1.2 Shqyrtimin e koncentrimin të rrezikut dhe rreziqet potenciale të vetvetishme që rrjedhin nga kompleksiteti i strukturës legale dhe organizative të bankës;
- 1.3 Analizën e ecurive me qëllim të identifikimit të rreziqeve të reja ose rreziqeve të shpejta emergjente si rezultat i ndryshimeve në kushtet e biznesit të bankës.
2. Procesi i vlerësimit ose i matjes së rreziqeve të zakonshme dhe kur është e nevojshme, të jashtëzakonshme, të rreziqeve të identifikuar sipas paragrafit 1 të këtij neni, duhet të bazohet në:
 - 2.1 Proceset e përcaktuara dhe të dokumentuara për vlerësimin ose matjen e humbjeve që janë në përputhje me metodologjitë e bankës për llogaritjen e kërkesave minimale të kapitalit;
 - 2.2 Përdorimin e përshtatshëm të manualeve të skenarëve (*angl. toolkit of scenarios*) në lidhje me shkaktarët e rreziqeve dhe ndërveprimet e rreziqeve;
 - 2.3 Përdorimi i bazave të të dhënave të përshtatshme dhe të besueshme.

Neni 12

Stres testet

1. Banka duhet të sigurojë qasje gjithëpërfshirëse për implementimin e stres testeve dhe analizës së ndjeshmërisë (në tekstin e mëtejshëm: stres testet), që përfshijnë:
 - 1.1 Identifikimin e shkaktarëve më të rëndësishëm të rrezikut dhe përgatitjen e skenarëve të përshtatshëm të stresit;
 - 1.2 Aplikimin e rezultateve të stres testeve me qëllim të:
 - 1.2.1 Identifikimit të rreziqeve dhe përmirësimit të ekspozimit të bankës ndaj këtyre rreziqeve;
 - 1.2.2 Rishikimit të përshtatshmërisë së vlerësimeve ose matjeve të rreziqeve;
 - 1.3 Hartimin e një udhëzuesi të matjes së menaxhimit të rrezikut të mundshëm të përmendur në nenin 13 paragrafi 1 të kësaj rregullore në raste të kushteve të pafavorshme të operimit për bankën (p.sh. përgatitjen e planeve të vazhdimësisë së biznesit).
2. Banka duhet të marrë parasysh rezultatet e stres testeve në procesin e rishikimit dhe planifikimit të gatishmërisë së bankës për të ndërmarrë rrezik, limitet e rrezikut dhe kapacitetin rrezik-mbajtës, planifikimin e kapitalit dhe likuiditetit të bankës, si dhe në vlerësimin e brendshëm të mjaftueshmërisë së kapitalit dhe qëndrueshmërinë e likuiditetit. Bordi i drejtorëve, komiteti i rrezikut, menaxhmenti i lartë dhe departamenti i auditimit të brendshëm duhet të informohen mbi rezultatet e stres testeve. Menaxhmenti i lartë konfirmon rezultatet e stres testeve në çdo rast.
3. Bordi menaxhues dhe menaxhmenti i lartë shqyrton dhe aprovon skenarët e stresit të përmendur në paragrafin 1 të këtij neni në secilën rast dhe njofton komitetin e rrezikut në përputhje me rrethanat.

Neni 13

Menaxhimi i rreziqeve të ndërmarra

1. Procesi i menaxhimit të rreziqeve të ndërmarra duhet të sigurojë përkufizimin dhe implementimin e masave të mundshme për menaxhimin e rrezikut duke përfshirë:
 - 1.1 Transferimin ose diversifikimin e rreziqeve (p.sh. nëpërmjet sigurimit) ose shmangies së rreziqeve (p.sh. përmes tërheqjes së një produkti ose linje biznesi);
 - 1.2 Kufizimin e rrezikut (p.sh. përmes vendosjes së kufijve të rrezikut);
 - 1.3 Pranimin e përkohshëm të rreziqeve të ndërmarra që tejkalojnë limitet e vendosura të rrezikut, për shkak se zbutja e tyre gjatë periudhës përkatëse nuk është e mundur;
 - 1.4 Pranimin ose ndërmarrjen e rreziqeve që nuk mund të zbuten në nivelin e limitëve të vendosura të rreziqeve ose që nuk mund të sigurohen në mënyrë adekuate.
2. Banka duhet të sigurojë që masat e përmendura në paragrafin 1, nën paragrafi 1.3 të këtij neni të zbatohen vetëm në raste të jashtëzakonshme dhe në bazë të aprovimeve të duhura nga menaxhmenti i lartë, i cili duhet të informohet rregullisht mbi efektet e këtyre masave.
3. Funkcioni i menaxhimit të rrezikut duhet të propozojë masat e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni për rreziqet e identifikuar dhe të vlerësuara ose të matura si dhe udhëzon dhe monitoron implementimin e tyre. Në rast të një vendimi nga bordi drejtues lidhur me pranimin e rreziqeve të rëndësishme të përmendura në paragrafin 1, nënparagrafët 1.3 dhe 1.4 të këtij neni, në bashkëpunim me njësitë organizative që ndërmarrin rreziqet, funksioni i menaxhimit të rrezikut siguron monitorimin e rregullt dhe raportimin e rreziqeve me qëllim të menaxhimit të këtyre rreziqeve brenda kufijve të rrezikut të pranuar ose në përputhje me vendimet e menaxhmentit të lartë dhe të bordit drejtues.

Neni 14

Monitorimi i rreziqeve dhe komunikimi rreth rreziqeve

1. Procesi i monitorimit të rreziqeve duhet të sigurojë komunikimin sistematik rreth rreziqeve në të gjitha nivelet hierarkike dhe organizative të bankës, duke përfshirë raportimin e rreziqeve në bordin e drejtorëve, menaxhmentin e lartë dhe në funksionet e kontrollit të brendshëm.
2. Monitorimi efektiv i rrezikut siguron që ndërmarrja e rreziqeve të jetë në përputhje me kufijtë e vendosur të rrezikut. Për këtë qëllim banka do të vendosë:
 - 2.1. Një sistem që në kohë të përshtatshme dhe të shpejtë lehtëson identifikimin e shkeljeve të limiteve të rrezikut duke marrë parasysh edhe natyrën dhe llojin e rreziqeve;
 - 2.2. Procedurat për trajtimin e shkeljeve të limiteve të rrezikut dhe për përcaktimin e shkaqeve të shkeljeve, duke përfshirë masat përkatëse;

- 2.3. Procedurat për informimin e bordit të drejtorëve, komitetin e menaxhimit të rrezikut, menaxhmentin e lartë dhe funksionin e menaxhimit të rrezikut lidhur me shkeljet e kufijve të rrezikut.

Neni 15

Raportet e rregullta dhe ad hoc mbi rreziqet

1. Raportimi mbi rreziqet e përmendura në nenin 14 paragrafi 1 të kësaj rregullore duhet të bazohet në një sistem transparent të raportimit që përfshinë raporte të rregullta dhe specifike mbi rreziqet.
2. Raportet e rregullta për rreziqet e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni duhet lehtësojnë monitorimin e vendimeve efektive në lidhje me masat për menaxhimin dhe kontrollin e rreziqeve, si dhe monitorimin e rezultateve të këtyre masave. Këto raporte duhet të sigurojnë një pasqyrë të qartë të profilit të rrezikut, veçanërisht në bazë të informacionit për:
 - 2.1 Shqyrtimin e gatishmërisë për të ndërmarrë rrezik në linja të ndryshme të biznesit dhe shkeljeve të kufijve të rrezikut;
 - 2.2 Rreziqet e rëndësishme të bankës dhe vlerësimet e tyre;
 - 2.3 Rezultateve të stres testit.
3. Raportet specifike për rreziqet e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni duhet të lehtësojnë raportimin më të hershëm të mundshëm të informacionit të jashtëzakonshëm për ndodhjen e një rreziku të rëndësishëm që kërkon vëmendje të menjëhershme ose veprim nga ana e bordit drejtues ose menaxhmentit të lartë. Menaxhmenti i lartë duhet ta informojë bordin e drejtorëve për rreziqet e tilla pa vonesë.
4. Në lidhje me përpilimin e raporteve mbi rreziqet, banka duhet të sigurojë një nivel të duhur të automatizimit në procesin e përgatitjes së raporteve individuale që sigurojnë pajtueshmërinë e tyre me situatën aktuale. Në rast të ndërhyrjeve manuale në përmbajtjen e një raporti, banka duhet të sigurojë kontrole të brendshme të përshtatshme (p.sh. të shënohet si pikë për auditim, parimi i katër syve).

Neni 16

Adekuatshmëria e raporteve mbi rreziqet

1. Qëllimi dhe detajet e raporteve mbi rreziqet duhet të marrin parasysh nevojat e përdoruesve të synuar të këtyre raporteve, si më poshtë:
 - 1.1 Bordi i drejtorëve të bankës, komitetet e rrezikut dhe menaxhmenti i lartë duhet të marrin informacione të plota për të gjitha çështjet e rëndësishme në lidhje me operacionet e bankës dhe rreziqet e saj;
 - 1.2 Departamenti i auditimit të brendshëm, funksioni i menaxhimit të rrezikut dhe menaxherët e tjerë të bankës duhet të marrin informata relevante rreth çështjeve kyçe në lidhje me operacionet e bankës dhe rreziqet e saj. Informacioni

konsiderohet i rëndësishëm nëse paraqitet në mënyrë transparente dhe përmbledhë pjesët e rëndësishme të çështjes duke konsideruar edhe prioritetin e saj.

2. Raportet mbi rreziqet duhet të jenë:
 - 2.1 *Të kuptueshme*; raportet konsiderohen të kuptueshme nëse ato përmbajnë informacion të qartë dhe të saktë për rreziqet;
 - 2.2 *Të mjaftueshme*; raportet konsiderohen të mjaftueshme nëse përmbajnë të gjitha rreziqet e rëndësishme dhe së bashku sigurojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të profilit të rrezikut të bankës;
 - 2.3 *Të dobishme*; raportet konsiderohen të dobishme në qoftë se ato përbëjnë një bazë për aprovimin e masave të përshtatshme;
 - 2.4 *Të krahasueshme dhe në pajtueshmëri*; raportet konsiderohen të krahasueshme dhe në pajtueshmëri nëse forma e tyre është e standardizuar në mënyrën më të mirë të mundshme në lidhje me informacionin që ato përmbajnë;
 - 2.5 *Në kohë*; raportet konsiderohen të paraqitura në kohë nëse ato lehtësojnë marrjen e vendimeve në një kohë të përshtatshme në lidhje me natyrën dhe llojin e rreziqeve.

Neni 17

Rreziqet nga produktet e reja dhe nga kontraktorët e jashtëm

1. Banka duhet të sigurojë që rreziqet e vetvetishme nga futja e produkteve të reja të jenë gjithashtu të përfshira në proceset e menaxhimit të rrezikut të referuara në nenin 10 të kësaj rregullore.
2. Nëse banka përdor kontraktuesit e jashtëm në kryerjen e aktiviteteve të saj të biznesit, proceset e menaxhimit të rrezikut të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni duhet të përfshijnë gjithashtu rreziqet që lidhen me përdorimin e kontraktuesve të jashtëm.

Neni 18

Politika për aprovimin e produkteve të reja dhe kontraktorëve të jashtëm

1. Për të menaxhuar rreziqet e vetvetishme nga futja e produkteve të reja, banka duhet të vendosë dhe zbatojë politikën për miratimin e produkteve të reja.
2. Për të menaxhuar rreziqet që lidhen me përdorimin e kontraktorëve të jashtëm, një bankë duhet të vendosë dhe zbatojë një politikë për përdorimin e kontraktorëve të jashtëm.

Neni 19

PVBMK si pjesë integrale e proceseve të menaxhimit të rrezikut

1. Banka duhet të sigurojë që PVBMK të jetë pjesë përbërëse e proceseve të menaxhimit të rrezikut të referuara në nenin 10 paragrafi 2 të kësaj rregullore. Për këtë qëllim, në implementimin e PVBMK dhe përlllogaritjeve korresponduese të vlerësimit të

brendshëm të kërkesave të kapitalit të bazuar në rrezik dhe vlerësimit të kapitalit të brendshëm, banka zbaton të njëjtat sisteme, procese, metodologji, të dhëna dhe përkufizime të rreziqeve si ato tashmë të aplikuara në identifikimin, vlerësimin ose matjen, menaxhimin, monitorimin dhe kontrollin e rreziqeve.

2. Bordi i drejtorëve duhet të sigurojë që rezultatet e PVBMK, duke përfshirë vlerësimin e brendshëm të kërkesave për kapital të bazuar në rrezik dhe vlerësimin e brendshëm të kapitalit, merren parasysh në:
 - 2.1. Adaptimin e vendimeve të biznesit të bankës;
 - 2.2. Përkufizimin dhe përshtatjen e strategjive të rrezikut, gatishmërisë për rrezik dhe kapacitetit rrezik mbajtës, si dhe në planifikimin afatgjatë të kapitalit të bankës.

Neni 20

Përgjegjësia e Bordit të Drejtorëve për aprovimin e PVBMK

1. Me qëllim të zbatimit të duhur të PVBMK, duke përfshirë edhe rezultatet në përshtatjen dhe mbikëqyrjen e vendimeve të biznesit dhe strategjive të rrezikut, bordi i drejtorëve duhet të miratojë përshtatshmërinë e PVBMK të paktën një herë në vit, duke përfshirë vlerësimin e brendshëm të kapitalit të bazuar në rrezik, kërkesat dhe vlerësimin e kapitalit të brendshëm dhe në çdo rast dhe masat përkatëse (në vijim: rezultatet e PVBMK). Për të bërë këtë:
 - 1.1 Menaxhmenti i lartë duhet të miratojë përshtatshmërinë e PVBMK dhe rezultatet e tij në bazë të njohurive të detajuara rreth objektivave, proceseve, procedurave dhe metodologjive të PVBMK;
 - 1.2 Bordi i drejtorëve miraton përshtatshmërinë e PVBMK dhe rezultatet e tij në bazë të sigurimit të informimit të përgjithshëm rreth konceptit dhe objektivave të PVBMK, duke përfshirë kuptimin e rëndësisë së rezultateve të tij dhe masave përkatëse;
 - 1.3 Me çdo miratim të përshtatshmërisë së PVBMK, bordi i drejtorëve dhe menaxhmenti i lartë konfirmojnë që PVBMK ka marrë parasysh strategjitë e rrezikut;
2. Për qëllim të miratimit dhe monitorimit efektiv të zbatimit të vendimeve të biznesit dhe strategjive të rrezikut të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni, banka duhet siguron që bordi i drejtorëve dhe menaxhmenti i lartë të informohen rregullisht se cilat nga rreziqet e bankës janë të adresuara në PVBMK, duke përfshirë vlerësimet e caktuara të brendshme të kërkesave të kapitalit të bazuar në rrezik.

Neni 21

Planifikimi dhe implementimi i PVBMK

1. Banka duhet të sigurojë përfshirjen e PVBMK në proceset e planifikimit të operacioneve të bankës për periudhën e ardhshme.

2. Banka duhet të sigurojë kompetenca dhe përgjegjësi adekuate për të gjitha njësitë dhe funksionet organizative për zbatimin, monitorimin, rishikimin dhe miratimin e vendimeve operacionale me qëllim të zbatimit të PVBMK, duke përfshirë përlllogaritjen e vlerësimit të brendshëm të bankës mbi kërkesat e kapitalit të bazuar në rrezik dhe vlerësimin e kapitalit të brendshëm. Kompetencat dhe përgjegjësitë konsiderohen të përshtatshme nëse ato vendosen në përputhje me kërkesat e mëposhtme:
 - 2.1. Funksionet e bankës që zhvillojnë metodologji në lidhje me menaxhimin e rrezikut dhe bëjnë vlerësimin e brendshëm të kërkesave të kapitalit të bazuar në rrezik, nga aspekti funksional dhe organizativ duhet të jenë të ndara nga njësitë e biznesit dhe njësitë e tjera organizative që ndërmarrin përsipër rreziqe dhe duhet të jenë brenda funksionit të menaxhimit të rrezikut, në pajtim me rregulloren për qeverisjen korporative të bankave;
 - 2.2. Njësitë e biznesit dhe njësitë e tjera organizative që ndërmarrin përsipër rreziqe, në PVBMK duhet të marrin pjesë nën udhëheqjen e funksionit të menaxhimit të rrezikut, i cili siguron baraspeshën e duhur të interesave midis ndërmarrjes së rreziqeve të bankës dhe menaxhimit të rrezikut.
3. Banka duhet të sigurojë burime të mjaftueshme njerëzore dhe kushte financiare për qëllimin e zbatimit të PVBMK, duke përfshirë përdorimin e përshtatshme të teknologjisë së informacionit.
4. Banka siguron që PVBMK të përditësohet rregullisht krahas ndryshimeve në mjediset e brendshme dhe të jashtme të bankës ose ndryshimeve në objektivat, strategjitë dhe politikat e përmendura në nenin 4 paragrafi 1 të kësaj rregullore.

Neni 22

Përfshirja e rreziqeve të identifikuara në PVBMK

1. Banka duhet të sigurojë që PVBMK të mbulojë të gjitha rreziqet e identifikuara të bankës, duke përfshirë rreziqet e vetvetishme nga futja e produkteve të reja dhe rreziqet e përdorimit të kontraktuesve të jashtëm, në bazë të konsoliduar dhe individuale.
2. Pavarësisht nga paragrafi 1 i këtij neni, për qëllim të përfshirjes së rreziqeve specifike të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni në PVBMK, banka në vend që të përdorë metodologjitë sasiore për përlllogaritjen e vlerësimit të brendshëm të kërkesave të kapitalit të bazuar në rrezik për rreziqet e lartpërmendura, ajo mund të përdorë edhe masat përkatëse të menaxhimit të rrezikut të përmendura në nenin 13 paragrafi 1 të kësaj rregullore. Në këtë rast banka duhet të sigurojë cilësi të lartë në përdorimin e masave të përmendura, duke i mbështetur ato me argumentim.
3. Banka të paktën një herë në vit duhet të sigurojë rishikim të përshtatshmërisë dhe përfshirjes së të gjitha rreziqeve të identifikuara në PVBMK duke marrë parasysh edhe çdo ndryshim të rëndësishëm në ekspozimin ndaj rrezikut.

Neni 23

Matja e rrezikut dhe përdorimi i modeleve të kapitalit ekonomik

1. Për qëllime të vlerësimit të brendshëm të kërkesave për kapitalin e bazuar në rrezik, banka duhet të sigurojë përdorimin e të dhënave gjithëpërfshirëse në matjen e rrezikut. Të dhënat konsiderohen të plota nëse mbulojnë të gjitha rreziqet e vetvetishme në modelin e biznesit, aktivitetet dhe produktet e bankës, në baza të konsoliduara dhe individuale. Banka duhet të siguroj rishikimin e rregullt dhe gjithëpërfshirës të të dhënave dhe koordinimin e të dhënave të përdorura me informacionet nga bilanci i gjendjes si dhe me të dhëna të tjera relevante që rrjedhin nga raportet financiare të bankës.
2. Banka që përdor teknika të avancuara të matjes së rrezikut, në matjen e rrezikut të saj (në tekstin e mëtejshëm: modeli i kapitalit ekonomik), duhet të sigurojë që modeli i kapitalit ekonomik, duke përfshirë edhe të dhënat e përdorura, përshtatet me modelin e biznesit, aktivitetet, produktet dhe rrethana të tjera të brendshme dhe të jashtme. Vlerësimi i përshtatshmërisë së modelit të kapitalit ekonomik mund të bëhet nga një prej tri mundësive organizative të bankës që janë të pavarura, të përcaktuara si në vijim:
 - 2.1 Dy njësi të ndara (d.m.th., njëra e cila zhvillon modelin dhe tjetra e cila validon modelin) të cilat i raportojnë antarëve të ndryshëm të menaxhmentit të lartë.
 - 2.2 Dy njësi (d.m.th., njëra e cila zhvillon modelin dhe tjetra e cila validon modelin) të ndara të cilat i raportojnë anëtarit të njëjtë të menaxhmentit të lartë.
 - 2.3 Ndarja e stafit (d.m.th., stafit që zhvillon modelin dhe stafi që validon modelin) në kuadër të të njëjtës njësi organizative që i raporton zyrtarit kryesor të rrezikut.
3. Në matjen e rrezikut të përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, banka duhet të sigurojë që çdo vlerësim i efekteve të masave të menaxhimit të rrezikut në llogaritjen e vlerësimit të brendshëm të kërkesave të kapitalit të bazuar në rrezik nuk vepron për të reduktuar vlerësimin e kërkesave të kapitalit, në mënyrë që zvogëlimi i vlerësimit të brendshëm të kërkesave për kapital të bazuar në rrezik, mund të jetë jo-proporcionale me efektin aktual të masave të menaxhimit të rrezikut.

Neni 24

Vlerësimi i brendshëm i kërkesave të kapitalit të bazuar në rrezik

Banka duhet të bëjë një vlerësim të brendshëm të kërkesave të kapitalit të bazuar në rrezik në bazë të metodologjisë së vet, duke përfshirë kombinimin e vlerësimeve të brendshme të kërkesave të kapitalit të bazuar në rrezik për rreziqet individuale ose një metodologjie tjetër të përshtatshme.

Neni 25

Vlerësimi i brendshëm i kapitalit dhe objektivi për mirëmbajtjen e kapacitetit rrezik mbajtës

1. Në bazë të objektivave të duhura për mirëmbajtjen e kapacitetit rrezik mbajtës, banka duhet të sigurojë përkufizimin e komponentëve të kapitalit të përfshirë në vlerësimin e kapitalit të brendshëm për qëllimet e PVBMK. Objektivat për mirëmbajtjen e kapacitetit rrezik mbajtës konsiderohen të duhura nëse janë të ndërtuara sipas qasjes së bankës për të siguruar mjaftueshmërinë e kapitalit sipas skenarëve të mëposhtëm dhe atë të paktën:
 - 1.1 Ruajtja e vazhdimësisë (parimi i vazhdimësisë së biznesit);
 - 1.2 Ruajtja e mjaftueshmërisë së kapitalit në situata emergjente (por të mundshme) të operacioneve të bankës;
2. Banka duhet të sigurojë vlerësimin e rregullt (së paku një herë në vit) të përshtatshmërisë së komponentëve të kapitalit të përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, duke përfshirë analizën e çfarëdo ndryshimi të planifikuar në lidhje me këta përbërës.

Neni 26

Planifikimi i kapitalit

Për qëllime të sigurimit të qëndrueshmërisë së mjaftueshmërisë së kapitalit, banka duhet të sigurojë planifikimin adekuat të kapitalit për një periudhë prej së paku 3 (tre) vitesh, e që merr parasysh qasjen e bankës ndaj shpërndarjes së dividendës dhe mundësinë e rikapitalizimit. Planifikimi i kapitalit duhet të bazohet në supozime realiste, duke pasur parasysh strategjinë e biznesit dhe strategjinë e rrezikut të përmendur në nenin 4 paragrafi 1 të kësaj rregullore si dhe çdo kufizim që rrjedh nga rregulloret, standardet dhe nga kërkesat e tjera të BQK-së.

Neni 27

Analiza e kapacitetit rrezik mbajtës

1. Banka duhet të sigurojë që vlerësimi i brendshëm i kapitalit të jetë në linjë me kapacitetin rrezik mbajtës në çdo kohë. Për këtë qëllim banka duhet të sigurojë analizën e kapacitetit rrezik mbajtës, duke përfshirë edhe skenarët për ruajtjen e kapacitetit rrezik mbajtës të përmendur në nenin 25 paragrafi 1 të kësaj rregulloreje.
2. Skenari për ruajtjen e kapacitetit rrezik mbajtës të bankës duke ruajtur vazhdimësinë të referuar në nenin 25 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 të kësaj rregullore, duhet të merr parasysh mbrojtjen e duhur të interesave të aksionarëve, bordit të drejtorëve, menaxhmentit dhe punonjësve të tjerë të bankës. Mbrojtja e këtyre interesave konsiderohet e përshtatshme nëse qasja në përlllogaritjen e kapitalit ofron mbrojtje nga zhvillimet që mund të rrezikojnë parimin e vazhdimësisë së bankës. Për qëllimet e këtij skenari, banka duhet të sigurojë gjatë gjithë kohës që vlerësimi i brendshëm i kërkesave të kapitalit të bazuar në rrezik të jetë së paku në nivelin e kërkesave të kapitalit të llogaritura në përputhje me Rregulloren për Mjaftueshmërinë e Kapitalit.

3. Skenari për mirëmbajtjen e kapacitetit të rrezik mbajtjes në situata emergjente, por të mundshme në veprimtaritë e bankës të përmendura në nenin 25 paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 të kësaj rregullore, duhet të marrë parasysh mbrojtjen e duhur të interesave të investitorëve dhe kreditorëve të bankës. Mbrojtja e këtyre interesave konsiderohet e përshtatshme nëse kapitali i bankës është i mjaftueshëm për të paguar kërkesat e kreditorëve të bankës.
4. Banka mund të përcaktojë edhe skenarë për mirëmbajtjen e kapacitetit rrezik mbajtës me qëllim të mbulimit të rreziqeve të tjera më pak të rëndësishme që janë paraqitur shpesh.
5. Banka duhet të monitorojë çdo faktor dhe arsye të shkeljes së kapacitetit rrezik mbajtës brenda skenarëve për mirëmbajtjen e kapacitetit të përcaktuar rrezik mbajtës.

Neni 28

Përdorimi i Stres Testeve

1. Për qëllim të matjes së vlerësimit të brendshëm të kërkesave të kapitalit të bazuar në rrezik, banka duhet të kryejë stres testet të paktën një herë në vit, sipas skenarëve të stresit që përfshijnë ndryshime në kushtet e tregut, duke pasur parasysh të gjitha subjektet relevante në grup. Për të identifikuar ndryshimet në kushtet e tregut që mund të kenë një ndikim negativ në mjaftueshmërinë e kapitalit të ardhshëm të bankës, stres testet, gjithashtu duhet të marrin parasysh gjendjen e ciklit aktual të biznesit në varësi të përkeqësimit të përgjithshëm të situatës ekonomike si rezultat i një rënie të aktivitetit ekonomik (recesioni) dhe një përkeqësimi specifik në sektorët ekonomik që banka i mbështet financiarisht.
2. Banka siguron që rezultatet e stres testeve të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni të merren parasysh në procesin e planifikimit të kapitalit të përmendur në nenin 26 të kësaj rregullore dhe në përcaktimin e masave në lidhje me strategjitë e rrezikut dhe politikat (nenet 5 dhe 6 i kësaj Rregullore), duke përfshirë profilin e rrezikut dhe planet e vazhdimësisë së biznesit.

Neni 29

Procesi i shpërndarjes së kapitalit

1. Banka duhet të sigurojë proces të përshtatshëm për shpërndarjen e kapitalit ndërmjet linjave të biznesit dhe / ose subjekteve në grup, në bazë të vlerësimit të brendshëm të kërkesave të kapitalit të bazuar në rrezik të përmendur në nenin 24 të kësaj rregullore dhe analizës së kapaciteti rrezik mbajtës të referuar në nenin 27 të kësaj rregullore. Procesi i shpërndarjes së kapitalit konsiderohet i përshtatshëm nëse lidh strategjinë e biznesit të bankës me strategjinë e saj të rrezikut.
2. Banka duhet të sigurojë një vlerësim të mjaftueshmërisë së kapitalit dhe shpërndarjes së kapitalit të paktën një herë në vit duke konsideruar çdo ndryshim të rëndësishëm në ekspozimin ndaj rrezikut.

Neni 30
Dokumentimi i procesit të PVBMK

1. Banka duhet të sigurojë ruajtjen sistematike të dokumentacionit të rëndësishëm lidhur me operacionet e bankës, menaxhimin e rrezikut, duke përfshirë zbatimin e kontrolleve të brendshme dhe raportimin e brendshëm të rreziqeve të bankës (në tekstin e mëtejshëm: dokumentacioni). Dokumentacioni që lidhet me procesin PVBMK duhet të përfshijë në veçanti:
 - 1.1. aktet nënligjore të bankës, duke përfshire kronologjinë e përditësimit të tyre (p.sh. strategjitë, politikat, kodet e sjelljes, udhëzimet);
 - 1.2. dokumentet përkatëse në lidhje me aktivitetet e njësive organizative (p.sh. vendimet e miratuara, analizat, masat, rezultatet financiare);
 - 1.3. një përshkrim të hollësishëm të PVBMK (p.sh. fushëveprimi i zbatimit, objektivat, metodologjitë, vlerësimet, procedurat, përlllogaritjet, masat);

Neni 31
Raportimi dhe afatet e raportimit në BQK

1. Banka duhet të përgatisë një raport vjetor mbi PVBMK duke u mbështetur në udhëzimet dhe strukturën e raportimit sikurse në Aneksin 1 të kësaj Rregullore.
2. Raportimi sipas paragrafit të 1 të këtij neni për procesin e vlerësimit të brendshëm të mjaftueshmërisë së kapitalit bëhet me gjendjen e 31 dhjetor të vitit paraprak dhe i paraqitet BQK-së më së voni deri më 30 prill të vitit aktual.
3. Degët e bankave të huaja duhet të dorëzojnë në BQK:
 - 3.1. raportin e PVBMK të bankës mëmë;
 - 3.2. strategjinë e bankës mëmë për degën;
 - 3.3. një raport të detajuar mbi procesin e vlerësimit të rrezikut dhe menaxhimit të rrezikut duke marrë parasysh profilin e rrezikut në përputhje me strategjinë e bankës mëmë për degën që vepron në Kosovë dhe kapacitetin e mbështetjes së kapitalit.
 - 3.4. Raportet dhe strategjia të përmendura në nënparagrafët 3.1, 3.2 dhe 3.3 të këtij paragrafi duhet të dorëzohen në BQK, jo më vonë se data 30 maj e vitit aktual.

Neni 32
Rishikimi i PVBMK

BQK si pjesë e procesit të saj mbikëqyrës, rishikon dhe vlerëson PVBMK, si dhe menaxhimin e rreziqeve nga ana e bankave, me qëllim të sigurimit të niveleve të mjaftueshme të kapitalit, për të monitoruar rreziqet e ndërmarra nga banka dhe për përdorimin, zhvillimin dhe përmirësimin e metodave të menaxhimit të rrezikut. BQK, rishikon dhe vlerëson PVBMK, duke u bazuar përgjithësisht në raportin e PVBMK dhe në

dialogun me bankën mbi mjaftueshmërinë e kapitalit dhe menaxhimin efektiv të rreziqeve në pajtim me kapacitetin rrezik-mbajtës të bankës.

Neni 33

Zbatimi, masat përmirësuese dhe dënimet civile

Çdo shkelje e dispozitave të kësaj rregulloreje do të jetë subjekt i masave përmirësuese dhe ndëshkuese, siç përcaktohet siç përcaktohet në Ligjin për Bankën Qendrore dhe Ligjin për bankat.

Neni 34

Anekset

Pjesë përbërëse e kësaj rregullore është Aneksi 1.

Neni 35

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi më datën 01.01.2020.

Flamur Mrasori

Kryetar i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës

Aneksi 1

Procesi i Vlerësimit të Brendshëm i Mjaftueshmërisë së Kapitalit (PVBMK) – Formati i Raportimit

1. Qëllimi i këtij aneksi është të ofrojë udhëzime për bankat në përgatitjen e dokumentit / raportit të PVBMK në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje.
2. Raporti i PVBMK duhet të miratohet nga bordi i drejtorëve dhe menaxhmenti i lartë i bankës.
3. Bankat në minimum duhet të paraqesin informatat sikurse në formatin e raportimit të mëposhtëm. Përveç kësaj, bankat duhet gjithashtu të plotësojnë një aneks shtesë që përshkruan metodologjinë e vlerësimit të rrezikut dhe të metodologjinë e përdorur për matjen e rreziqeve.
4. Niveli i detajimit të dokumentit të raportit PVBMK do të ndryshojë në bazë të madhësisë dhe kompleksitetit të bankave. Informacionet plotësuese siç janë politikat, kornizat e menaxhimit të rrezikut dhe proceset mund të referohen nëpërmjet anekseve.

Elementet e Formatit te Raportit PVBMK	
1	Përmbledhja Ekzekutive
2	Gjendja e Përgjithshme e PVBMK
3	Informacioni mbi Strategjinë dhe Modelin e Biznesit
4	Informacioni mbi Menaxhimin e Rreziqeve dhe Kornizës se Menaxhimit
5	Informacioni për Gatishmërinë për të Ndërmarrë Rrezik
6	Rreziqet e Rëndësishme
7	Kapacitetit Rrezik - Mbajtës
8	Informacioni rreth Planifikimit të Kapitalit
9	Stres Testet
10	Integrimi i PVBMK në Menaxhimin e Rreziqeve
11	Sfidat dhe Hapat e Mëtejme
Informatat tjera	
Forma e raportimit	Raporti Përmbledhës i Matjeve Kyçe të PVBMK
Aneksi	Metodologjia e Vlerësimit të Rrezikut dhe Metodologjia e Përdorur për Matjen e Rreziqeve

Formati i Raportit të PVBMK

Përmbledhja Ekzekutive	<p>Përmbledhja duhet të ofrojë një pasqyrë të kornizës së PVBMK dhe rezultatet e tilla si:</p> <ul style="list-style-type: none">• Konfirmimin që banka (në bazë të konsoliduar) ka vlerësuar nëse kapitali i saj është i mjaftueshëm duke pasur parasysh madhësinë dhe kompleksitetin e biznesit të saj;• Komentimin mbi rreziqet e rëndësishme (materiale) me të cilat ndeshet banka, pse niveli i rrezikut është i pranueshëm ose nëse nuk është, atëherë cilat veprime lehtësuese janë planifikuar.• Përmbledhje e gjetjeve kryesore të analizës PVBMK, e cila përfshinë:<ul style="list-style-type: none">• nivelin dhe përbërjen e kapitalit të brendshëm që banka vlerëson se duhet të mbahet krahasuar me kërkesat e kapitalit rregullator sipas "Shtyllës I" (ju lutemi plotësoni formën <i>PVBMK - Raporti Përmbledhës i Matjeve Kyçe</i> për të krahasuar komponentët e rrezikut të përfshirë në kapitalin e përlogaritur sipas Shtyllës I dhe vlerësimin sipas PVBMK);• përshtatshmërinë e proceseve të menaxhimit të rreziqeve;• nëse banka ka burime të mjaftueshme të kapitalit gjatë horizontit të saj të planifikimit; dhe• një përmbledhje të planeve të kapitalit të miratuara nga bordi - në minimum këto duhet të përfshijnë kapitalin bazë të klasës së parë (angl. CET1), kapitalin e klasës së parë (angl. Tier 1), gjithsej kapitalin rregullator të bankës, si dhe shumat / strukturën e kapitalit rregullator dhe vlerësimet e kapitalit të brendshëm.▪ Përmbledhje të gjendjes financiare të bankës, strategjisë së saj të biznesit, strukturës së bilancit dhe parashikimit të fitimeve.▪ Përshkrimin e shqyrtimit, sfidave dhe procesit të miratimit të PVBMK.
-------------------------------	---

<p>Përmbledhje e PVBMK</p>	<p>Kjo pjesë duhet të ofrojë një pasqyrim të cilësisë së lartë të implementimit të PVBMK në banka, duke ofruar një analizë të integruar të kornizës së menaxhimit të rreziqeve të bankës, planifikimit të biznesit dhe menaxhimit të kapitalit. Përmbledhja duhet të mbulojë politikat dhe sistemet relevante të përdorura nga banka për të identifikuar, menaxhuar dhe monitoruar rreziqet duke u bazuar në gatishmërinë për të ndërmarrë rrezik dhe kapacitetin rrezik-mbajtës të saj.</p>
<p>Informacioni mbi Strategjinë dhe Modelin e Biznesit</p>	<p>Në këtë pjesë bankat duhet të ofrojnë një pasqyrim të cilësisë së lartë të strategjisë dhe modelit të biznesit të bankës, strategjive të rrezikut dhe politikave të rrezikut dhe ndërlidhjeve të përmendura në nenin 4 të kësaj rregulloreje. Këtu, banka, gjithashtu, duhet të japë një përshkrim të modelit aktual të biznesit duke përfshirë identifikimin e biznesit bazë linjat, tregjet, vendet dhe produktet që ofron banka; paraqitjen e përcaktuesve kryesorë të të hyrave dhe shpenzimeve, të alokuara sipas linjave kryesore të biznesit dhe tregjeve; si dhe strategjinë afatgjatë në aspektin e përshkrimit të ndryshimeve të planifikuara nga banka në modelin aktual të biznesit dhe aktivitetet e tij themelore.</p>
<p>Informacioni mbi Qeverisjen e Rreziqeve dhe Strukturën e Menaxhmentit</p>	<p>Kjo pjesë duhet të ofrojë një pasqyrim të nivelit të lartë dhe një përshkrim të marrëveshjeve të përgjithshme të qeverisjes korporative brenda bankës, përfshirë rolet dhe përgjegjësitë në menaxhimin e rrezikut dhe kontrollit, duke përfshirë edhe nivelet e përfshirjes së bordit të drejtorëve dhe menaxhmentit të lartë në këto procese; përshkrimin e linjave të raportimit dhe frekuencën e raportimit të rregullt tek menaxhmenti; përshkrimin e bashkëveprimit ndërmjet matjes së rrezikut dhe monitorimit, si dhe praktikave aktuale të ndërmarrjes së rreziqeve (p.sh. përcaktimi i limiteve, monitorimi, trajtimi i shkeljeve etj.);</p>
<p>Informacioni rreth gatishmërisë për të marrë Rrezik</p>	<p>Kjo pjesë duhet të ofrojë një pasqyrë të nivelit të lartë të gatishmërisë për të ndërmarrë rrezik nga ana e bankës, duke përshkruar edhe shpeshhtësinë e rishikimit të tolerancës së rrezikut nga menaxhmenti i lartë dhe bordi i drejtorëve.</p>
<p>Rreziqet Materiale</p>	<p>Në këtë pjesë duhet të jepet një përshkrim i shkurtër i procesit të identifikimit të rreziqeve të nga ana e bankës dhe përshkruhet se si banka identifikon fushat e rreziqeve materiale (të rëndësishme).</p>

	<ul style="list-style-type: none"> • Në një aneks të veçantë (të përfshihet Aneksi në formatin e dorëzimit të raportit të PVBMK), duhet të ofrohet hollësi e mëtejshme mbi vlerësimin e rreziqeve nga banka dhe metodologjia e kuantifikimit, duke përfshirë: <ul style="list-style-type: none"> • Mënyrën/metodologjinë se si banka përcakton secilin nga rreziqet kryesore, si dhe çdo rrezik tjetër të identifikuar si kyç bazuar në profilin e rrezikut të bankës; • Se si banka përcakton materialitetin e çdo rreziku kryesor; dhe • Një përshkrim se si secili rrezik material pastaj kuantifikohet për qëllimin e alokimit të kapitalit, duke përfshirë metodologjinë e detajuar për të specifikuar të dhënat, supozimet dhe llogaritjet.
<p>Kapaciteti Rrezik-Mbajtës</p>	<p>Kjo pjesë duhet të ofrojë një pasqyrim të nivelit të lartë të kapacitetit rrezik-mbajtës të bankës dhe mirëmbajtjes së kapacitetit rrezik- mbajtës.</p> <p>Banka këtu në mënyrë përgjithshme paraqet metodologjinë dhe procesin për vlerësimin e kapacitetit të rrezik, duke përfshirë edhe analizën e kapacitetit rrezik-mbajtës sipas kërkesave të nenit 27 të kësaj rregulloreje.</p> <p>Në aneks paraqitet në hollësi metodologjia, përlllogaritjet, si dhe i gjithë procesi, duke përfshirë analizën në detajuar te kapacitetit rrezik-mbajtës.</p>
<p>Informacioni rreth Planifikimit të Kapitalit</p>	<p>Kjo pjesë duhet të përfshijë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Parashikimet e kapitalit "bazë" të bankës (të paktën në baza tremuajore, bazuar në planin vjetor të biznesit); • Pozicionin e kapitalit 3-vjeçar përmbledhës; dhe • Përshkrim e procesit të planifikimit dhe menaxhimit të kapitalit të bankës, duke përfshirë një skicë të asaj se si PVBMK është inkorporuar në këtë process, si dhe inkorporimi me strategjinë e biznesit dhe strategjinë e rrezikut.
<p>Stres Testi</p>	<p>Në këtë pjesë duhet të jepet një përshkrim konciz se si përdoren teknikat/programi i stres testit nga banka për të mbështetur vlerësimin dhe menaxhimin e mjaftueshmërisë së kapitalit.</p> <p>BQK pret që bankat të kryejnë stres testet për të gjitha portofoliot materiale dhe rreziqeve të rëndësishme.</p> <p>Në aneks paraqiten në mënyrë të hollësishme metodologjitë e stres testeve.</p>

<p>Integrimi i PVBMK ne Menaxhmentin e Rreziqeve</p>	<p>Në këtë pjesë duhet të paraqitet:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ përmbledhja se si PVBMK përdoret nga banka dhe si është bërë pjesë në procesin e vendimmarrjes; ▪ përshkrimi se si janë integruar rezultatet e PVBMK në përcaktimin dhe monitorimin e kufijve të rrezikut; dhe ▪ përshkrimi se si rezultatet e PVBMK si dhe raporti i PVBMK janë raportuar dhe aprovuar në menaxhmentin e lartë dhe bordin e drejtorëve.
<p>Veshtirësite & Hapat e Ardhshëm</p>	<p>Në këtë pjesë duhet të paraqitet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • përmbledhja e shkallës së vështirësive dhe e testimit të PVBMK, si dhe proceset e kontrollit të aplikuara në përlllogaritjet e PVBMK. • përshkrimin e procedurave të nënshkrimeve nga bordi dhe menaxhmenti i lartë; • Përshkrimi i procesit të rishikimit të PVBMK duke përfshirë edhe rishikimin nga njësi e pavarur organizative dhe/ose palët e tjera. • Identifikimi i planeve për të përmirësuar PVBMK në drejtim të rritjes së vlerësimeve për të ardhmen.

PVBMK - Raporti Përmbledhës i Matjeve Kyçe

Institucioni:		Fundviti Finaciar:	
Data e Raportimit:		Mjetet e Peshuara me Rrezik: (000 Euro)	
Miratimi nga Bordi:		Gjithsej Ekuiteti (000 Euro)	

Elementet e PVBMK	Kërkesat e Kapitalit sipas Shtyllës I (në 000 EUR)	Matjet e PVBMK (në 000 EUR)	(Referenca në Shtojcën 2 të raportit të PVBMK)
Rreziqet subjekt i kërkesave minimale për kapital			
Rreziku kreditor			
Rreziku i tregut			
Rreziku operacional			
Gjithsej Rreziqet sipas Shtyllës I			
Rreziqet që nuk janë të mbuluara plotësisht me kërkesat minimale të kapitalit			
Rreziku i mbetur (nga rreziku kreditor)			
Rreziku i sekjuritizimit			
Rreziku (nga rreziku i tregut)			
Rreziku i valutës			
Rreziqet që nuk janë subjekt i kërkesave minimale të kapitalit			
Rreziku i normave të interesit			
Rreziku i koncentrimt			
Rreziku i kundërpalës			
Rreziku i likuiditetit			
Rreziku reputacional			
Rreziku i modelit			
Rreziku i profitabilitetit			
Rreziku strategjik			
Rreziku i kapitalit			
Rrezik i pajtueshmërisë			
.....			
(Nëse nevojitet shtoni ndonjë rresht)			
Gjithsej Rreziqet sipas Shtyllës II			
Kapitali i nevojshëm shtesë nga stres testi dhe planifikimi i kapitalit			
Vlerësimi i brendshëm i kapitalit të bazuar në rrezik			
Efektet e diversifikimit (-)			
prej të cilit:			
a) për të njejtin rrezik			
b) për rreziqet e ndryshme			
Gjithsej kërkesat e kapitalit /matjet	<i>Gjithsej kërkesat e kapitalit sipas Shtyllës I</i>	<i>Gjithsej kërkesat e kapitalit sipas Shtyllës II</i>	

Forma Përmbledhëse e Planifikimit të Kapitalit

(000 Euro)	Gjendja Aktuale (t)	Viti (t+1)	Viti (t+2)	Viti (t+3)
Ekspozimet e Peshuara me Rrezik				
Kapitali Rregullator				
Kërkesat Minimale për Kapital (sipas Shtyllës I)				
Raporti I Mjaftueshmërisë së Kapitalit (%)				
Kërkesat e kapitalit (sipas Shtyllës II)				
Gjithsej Kërkesat e Kapitalit				